

KOMUNA VUSHTRRI

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

Në mes

KOMUNËS SË VUSHTRRISE

(Më poshtë: Komuna, përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës)

Dhe

OJQ - DEVELOPING TOGETHER

(Më poshtë: DT përfaqësuar nga Driton Tafallari, Drejtor)

PËR

PËRPILIMIN E PROGRAMIT TRE VJEÇAR PËR BANIM (2019-2021) NË KUADËR
TËPROJEKTIT TE FINANCUAR NGA DSP II

“Banimi për të gjithë”

Neni 1- Qëllimi i MiM

Ky Memorandum i Mirëkuptimit, përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e bashkëpunimit dhe partneritetit në mes të palëve, ku DT zotohet se do të ndihmojë Komunën për përpilimin e Programit tre Vjeçar për Banim i cili program do të ndihmojë komunën që të përballojë më lehtë nevojat për banim të banorëve të vet.

Po ashtu përpilimi i Programit Tre Vjeçar për Banim është edhe obligim ligjor sipas ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (Ligji nr 03L - 164).

Aktiviteti në fjalë është pjesë e projektit “Banimi për të gjithë” i financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Projekti realizohet nga OJQ Developing Together.

Neni 2

Rreth organizatës

Developing Together merret me çështjen e banimit që nga themelimi i vet më 2004. DT ka qenë partner i UNHCR-it dhe shumë organizatave tjera dhe si i tillë ka ndihmuar shumë familje në nevojë për strehim dhe infrastrukturë bazike, sidomos atyre minoritare. DT e financuar nga: Zyra e BE'së në Kosovë/IOM (RRK III), UNHCR, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Qeveria Britanike si dhe nga UNDP, që nga viti 2004 ka zbatuar projekte për ndërtimin e shtëpive individuale për më tepër se 1,200 familje të financuara nga donatorë të ndryshëm.

Gjatë viteve 2016 dhe 2017 DT ka realizuar një projekt të financuar nga EU me emrin "**Banimi, një e drejtë themelore njerëzore**". Gjatë realizimit të këtij projekti, DT ndër të tjerash ka ndihmuar shtatë komuna që të përpilojnë programet Tre-Vjeçare për banim.

DT vazhdon që të ndihmojë komunat tjera që të përpilojnë këto programe Tre Vjeçare për Banim. Pas diskutimeve dhe konsultimeve paraprake, palët e këtij Memorandumi janë dakorduar që një nga komunat përfituese të këtij aktiviteti të jetë komuna e Vushtrisë.

Neni 3

Qëllimi i Projektit

E drejta për banim është njëra ndër të drejtat themelore të njeriut që garantohet me Kushtetutë, me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Nga aspekti social, banimi adekuat është një e drejtë themelore e njeriut ndërsa nga aspekti i planifikimit hapësinor/urban banimi konsiderohet si shfrytëzues më i madhi i hapësirës. Si çështje sociale dhe çështje e planifikimit strategjik të një vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst qasja në banim është një disiplinë multisektoriale, mjaft komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e "Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit" i është dhënë një kornizë më e avancuar autoriteteve vendimmarrësve lokale për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Sigurimi i Banimit është bazë për funksionalizimin e familjes, shoqërisë por edhe vet shtetit, si për nga stabiliteti psiko-social ashtu edhe ekonomik. Andaj me përpilimin e përbashkët të Programit Trevjeçar për Banim, Komuna do të ketë mundësi që në mënyrë profesionale të planifikojë adresimin e çështjeve të banimit për kategoritë e popullatës që nuk kanë fuqi ekonomike për të siguruar banim të përballueshëm.

Andaj qëllimi i hartimit të Programeve tre vjeçare të banimit në Komunën tuaj është adresimi i çështjeve të banimit në territorin e komunës suaj, bazuar në

politikat qendrore të banimit, së pari duke bërë analizën e të gjitha të dhënave analitike e statistikore që paraqesin situatën faktike të banimit dhe nevojave në të ardhmen, duke u bazuar në analizën e trendëve, të rritjes së popullsisë, rritjes ekonomike etj.

Neni 4

Korniza Ligjore për hartimin e programeve tre vjeçare për banim

• Ligji Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe 6 Udhëzimet Administrative të këtij Ligji (UA për Përmbajtjen e Kontratës për Banesën me Qira Jo-profitabile; UA për përmbajtjen e Bonusit të Banimit; UA për Procedurat e Përfitimit nga Programet e Veçanta të Banimit; UA për Normat e Banimit për Programet e Veçanta të Banimit; UA për Procedurat e Shpalljes të Programeve të Veçanta të Banimit; UA për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit si dhe Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale tre vjeçare të banimit:

- Ligji nr 04/L-134 për Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi;
- Ligji Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave me të drejta banesore;
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji për Procedurat Administrative 2005/02-L28;
- Statuti i Komunës;
- Plani Zhvillimor Komunal dhe Plani Zhvillimor Urban Komunal.

Neni 5

Obligimet e Komunës

1. Formon Grupin Punues për Hartimin e Programit Trevjeçar për Banim përmes një vendimi nga Kryetari i Komunës. Anëtarët e Grupit Punues preferohet të jenë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra për Kthim dhe Ri-integrim dhe nga Zyra për të Drejtat e Njeriut);
2. Jap sygjerrime konkrete gjatë hartimit të metodologjisë për hartimin e Programit Trevjeçar të Banimit nga DT;
3. Jap sygjerrime konkrete gjatë hartimit të pyetësorëve, mostrës dhe dokumenteve tjera nga DT;
4. Siguron të dhënat e nevojshme për banim (sipas metodologjisë së përcaktuar nga Komuna dhe DT) që ekzistojnë në kuadër të drejtorive komunale si dhe institucionet tjera përkatëse si Enti i Statistikave, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Qendra për Punë Sociale,

Qendra për Punësim dhe të tjera. Poashtu në bashkëpunim me DT siguron edhe të dhënat faktike për banim nga terreni;

5. Identifikon grupet e synuara (përfituesit potencial për banim social);
6. Kategorizon grupet e synuara dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë (UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit;
7. Analizon strukturën e Buxhetit Komunal në raport me investimet në banim;
8. Përpunon dhe analizon të dhënat e mbledhura për banim në bashkëpunim me DT;
9. Drafton dokumentin;
10. Konsulton publikun dhe palët tjera të interesit gjatë hartimit të Programin trevjeçar të banimit;
11. Dërgon Draft-Programin Trevjeçar për Banim në Kuvend të Komunës për aprovim;
12. Dërgon kërkesën në Ministrinë e Pushtetit lokal dhe të MMPH-së për aprovim te ligjshmërisë;

Neni 6

Obligimet e Developing Together

1. Zhvillon metodologjinë (në konsultim të ngushtë me grupin punues) për hartimin e Programit Trevjeçar për Banim (përfshirë planin e punës me kohëzgjatjen e aktiviteteve) përmes një punëtorie një-ditore;
2. Identifikon të gjitha të dhënat nevojshme për analizën e banimit si psh. numri i njësive të banimit, lokacioni, shtrirja hapësinore, tipologjia, numri i ekonomive familjare, numri i njësive të zbrazëta për banim etj;
3. Zhvillon pyetësorët e nevojshëm për mbledhjen e të dhënave;
4. Zhvillon strukturën/ databazën (excel) për regjistrimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave;
5. Zhvillon planin e mbledhjes së të dhënave (përfshirë kohëzgjatjen);
6. Krijon mostrën/strukturën e e Programit Trevjeçar për Banim;
7. Prezanton mostrën te Grupi Punues i formuar nga Kryetari me sqarimet e nevojshme për plotësimin e dokumentit;
8. Asiston Grupin Punues në mbledhjen e informatave të nevojshme për draftimin e dokumentit;
9. Angazhon një ekspert për të ndihmuar Grupin Punues në draftimin e dokumentit me theks të veçantë në promovimin e Partneritetit Publiko Privat (PPP);

10. Asiston Grupin Punues në organizmin e takimeve konsultative me qytetarë gjatë hartimit të programit;
11. Kontrollon draftin final të dokumentit duke dhënë sugjerime sipas nevojës;
12. Ndhmon grupin punues në përgaditjet për organizimin e shqyrtimit publik të draftit final;
13. Asiston komisionin në mbrojtjen e draftit të përpiluar para kuvendit komunal (sipas nevojës);

Neni 7

Zgjidhja e kontesteve

Çdo kontest, kundërthënie apo kërkesë që paraqitet në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit zgjidhet përmes konsultimeve, pajtimit dhe/apo negociatave ndërmjet Komunës dhe DT'së, pra zgjidhet nga palët me një marrëveshje të dyanshme.

Neni 8

Komunikimi

Secila palë cakton në vijim kontaktin zyrtar dhe koordinatorin për zbatimin (kryerjen) e këtij Memorandumi (MiM).

Kontakt personat nga të dy palët nënshkruese janë:

1. Naim Ferizi, Shef i Sektorit për Shëndetësi
2. Haxhi Mehani, Developing Together


Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është nënshkruar në dy kopje identike, nga një për secilën palë në gjuhën Shqipe.

Nënshkruar në Vushtrri, Kosovë më datë _____

Në emër të Komunës



Z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës

Në emër të projektit : "Banimi për të gjithë", OJQ Developing Together

Z. Driton Tafallari, Drejtor

